



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr. 4222 Prot

Shkodër, më 04.03.2020

URDHËR

Nr. 223, datë 04.03.2020

**“PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR MONITORIMIN DHE
VLERËSIMIN E HIGJENËS TË AMBIENTEVE DHE HAPËSIRAVE TË
EKSOPOZUARA NDAJ VIRUSIT COVID-19”**

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimit Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, të ligjit nr 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, kërkesës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për marrjen e masave lidhur me infeksionin e shkaktuar nga virusi Covid-2019”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupeve të punës për monitorimin dhe vlerësimin e mjediseve/ambienteve të ekspozuara ndaj virusit Covid-19, për shkak të mbijetesës së këtij virusi në mjedise të kontaminuara potencialisht.
2. Grupin për monitorimin e sigurimit të dezinfektimit dhe ruajtjen e kushteve tekniko-sanitare, higjienike në mjetet e komunikacionit publik.
 - z. Nikolin Guri Përgjegjës, Sektori i Emergjencës Civile, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastruktues.
 - z. Vildan Broja, Përgjegjës, Sektori i Sinjalistikës, Transportit dhe Mobilitetit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastruktues.
3. Grupin për monitorimin e sigurimit të veshjeve mbrojtëse të përshtatshme individuale nga personat përgjegjës për shërbimin e pastrimit gjatë kryerjes së detyrës.
 - Z. Ilo Hajkoja, Specialist, Njesia e Monitorimit të Shërbimeve Publike, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastruktues.
 - Znj. Eva Poja, Specialist, Njesia e Monitorimit të Shërbimeve Publike, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastruktues.

- Znj. Linda Bala, Specialiste, Njesia e Monitorimit te Sherbimeve Publike, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastruktures.
4. Grupin për monitorimin e sigurimit të veshjeve mbrojtëse të përshtatshme individuale nga personat përgjegjës për shërbimin e gjelbërimit gjatë kryerjes së detyrës.
- Z. Behar Fejza, Specialist, Njesia e Monitorimit te Sherbimeve Publike, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastruktures.
5. Grupet e punës, çdo javë sipas kalendarit më poshtë të bëjnë inspektime të vazhdueshme për kontrollet e higjenës, të mjediseve/hapsirave/ambienteve si një element i shtuar për të paraprirë përhapjes së virusit për sa i përket masave të mbrojtjes.

6.

Grupet/ditet e javes	Hënë	Martë	Mërkurë	Enjte	Premte	Shtunë
Grupi I	Plani i inspektimeve sipas linjës së transportit					
	3	3	3	3	3	3
	Raport 1					
Grupi II	Plani i inspektimeve për shërbimin e pastrimit në pika të ndryshme gjatë kohës së kryerjes së shërbimit					
	3	3	3	3	3	3
	Raport 2					
Grupi III	Plani i inspektimeve për shërbimin e gjelbërimit në pika të ndryshme gjatë kohës së kryerjes së shërbimit					
	3	3	3	3	3	3
	Raport 3					

7. Të hartojnë shkresat drejtuar subjekteve që ofrojnë shërbimin përkatës për respektimin e normave dhe standarteve të higjenës, dhe sigurimit të veshjeve mbrojtëse për stafin dhe mjetet e shërbimit.
(afati 1 ditë)
8. Çdo të hënë të hartojnë raportin mbi punën e realizuar sipas formateve respektive bashkëngjitur (Raport 1, Raport 2, Raport 3) duke saktësuar të dhënat e verifikuara mbi situatën. Në rast të verifikimit të ndonjë pa rregullsie, të informojnë menjëherë subjektin me shkresë për respektimin e standartit të kërkuar.
(çdo të hënë)
9. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet grupet e punës.
10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

